



VENDIM

Nr. 154, Datë 11.12.2015

**MBI
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT
TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, dhe 58 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, dhe relacionin përkatës,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI**

